




Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Malishevë



PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 30.06.2023
PRIMLJENO:
Nr. Nn/P: 01/912

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

**Sipas rekomandimit të zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës për të
gjeturat e vitit 2022**

Nr.	Komponent a e auditimit (kapitulli)	Gjeja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtar/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandi mit	Kome nte
1	Çështja A1 Mungesë e projektit ekzekutiv si pjesë e specifikave teknike.	Neni 28.10 i LPP kërkon: Specifikat Teknike p: Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuar. Specifikat teknike duhet të përfshijnë si pjesë substanciale të veten një projekt ekzekutiv. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatuar duhet ti bashkangjitet	Kryetari duhet të rishikoj kontrollat e vendosura në procesin e planifikimit dhe inicimit të projekteve investuese dhe të siguron se gjatë përgatitjes së specifikave teknike për projekte investuese të kenë përgatitur edhe projektin ekzekutiv, dhe te njëjtin t'ia bashkngjiesin ndosjes së tenderit me rastin e publikimit të saj .	Do të kemi kujdes të veçantë që të zgjidhet ky problem, duke zhvilluar procedurat për kontraktimin e kompanive për hartimin e projekteve.	Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Administratës dhe Zyra e Prokurimit .	Në pjesën e dytë të vitit 2023.	
2	Çështja B1 – Mangësi në regjistrim dhe vlerësim/zhv erësim të pasurisë jo financiare.	Neni 1 i Rregullorës 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare përcakton procedurat standarte për dokumentimin, ruajtjen dhe jetësimin e pasurisë jo financiare, mbajtjen e saktë të të dhënave mbi pasurin jo financiare përmes mirëmbajtjes sistematike të regjistrimit të pasurive jo financiare kapitale si pjesë integrale e SIMFK-së dhe regjistrimit të pasurive jo financiare jo kapitale me qëllim të vlerësimit dhe raportimit të	Kryetari duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme në forcimin e kontrolleve të brendëshme për korigjimin e regjistrimit të pasurive, dhe në veçanti duke i verifikuar dhe korigjuar vlerat e pasurive me statutin “investime në vijim” dhe nëse jetëgjatësia e përdorimit të pasurive është ajo e përcaktuar me rregullore dhe që vlera e	Kemi trajnuar zyrtarin për E- Pasurisë dhe i kemi caktuar zyrtarët e depos të cilët presin që të trajnohen për regjistrimin e mallit të depos, në mënyrë që pasuritë nën 1,000€ të regjistrohen në tërësi. .	Zyra e Kryetarit, Drejtoria p%or Ekonomi, Buxhet dhe Financave.	Gjatë vitit 2023.	

		vlerës së tyre si dhe proceset adekuate, efektive dhe transparente të vjetërsimit të pasurive jo financiare.	pasurive të prezantohet e saktë. Po ashtu pasuria nën 1,000€ të regjistroheshin e gjitha në sistemin e “e-pasuria”.				
3	Çështja B2 – Ekzekutimi i pagesave për projekte të caktuara nga buxheti i projekteve tjera .	Ligji 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2022, nën 16 pika 1 tregon se ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese apo zëvendësimin e projekteve kapitale të komunave duhet të miratohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal. Ministri i Financave mundet nëse i afrohen arsyetimet të vlefshme nga ana e kryesuesit të organizatës buxhetore, të autorizojë lëvizjen e mjeteve të alokuara nga një projekt kapital në tjetrin brenda nën-programit të njëjtë asaj organizate buxhetore. Rialokimet duhet të kryhen në përputhje me procedurat dhe kriteret e parapara me udhëzimin administrativ MF nr.05/2019 për procedurat e transferit dhe riallokimit të ndarjeve buxhetore.	Kryetari duhet të sigurojë që gjatë ekzekutimit të pagesave për investime kapitale për të gjitha rastet, të respektohen shumat dhe kodet e projektit përkatës siç janë të miratuara në ligjin e ndarjeve buxhetore dhe nëse paraqitet nevoja për ndryshimin e shumave appo të projekteve atëherë të kërkohet miratimi paraprak i Kuvendit Komunal.	Neve do ti ndërmarrim të gjitha masat që me rastin e paraqitjes së nevojës për ndryshimin e kodeve të projekteve buxhetore të respektojmë procedurat e tyre duke kaluar përmes vendimeve të Asamblesë Komunale.	Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa	Në pjesën e dytë të vitit 2023.	
4	Çështja B3 – Vonesa në pagesën e faturave të pranuar.	Ligji Nr. 03/L-048 për MFPP, nën 39.1, përcakton që ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe	Kryetari duhet të sigurojë një planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe iniciimin e procedurave të shpenzimeve të realizohet	Neve do të respektojmë afatin për kryerjen e pagesave.	Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa	Gjatë vitit 2023.	

		shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.	vetëm kur mjetet janë në dispozicion, me qëllim të eliminimit të vonesave për pagesat e faturave apo të shmangies së padive eventuale nga operatorët ekonomik.			
5	Çështja B4 - Keq klasifikimi i shpenzimeve	Sipas nenit 18, pika 3 e rregullores 01/2013 -MF për Shpenzimin e Parasë Publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.	Kryetari duhet të sigurojë që planifikimi buxhetor i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive adekuate si dhe pagesat të regjistrohen në kode përkatëse ekonomike në përputhje me planin kontabël të aprovuar nga Thesari.	Me rastin e realizimit të shpenzimeve nga Organizata, jonë buxhetore, do të marrim të gjitha masat që obligimet e mbetura ti procedojmë me kohë me qëllim të shmangies së procedurave përmbartimore e cila po ndikon në keq klasifikim të pagesave në sistem. Gjithashtu ne do ti respektojmë procedurat e shpenzimeve duke bërë pagesat sipas kategorive adekuate dhe kodeve ekonomike.	Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa	Gjatë vitit 2023.
6	Çështja A2 – Në specifikat teknike të tenderit	Neni 28.4 i LPP kërkon: Autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike	Kryetari duhet të sigurojë se gjatë përgatitjes së specifikave teknike për punë, njësia kërkuese	Do të marrim të gjitha masat e nevojshme me rastin e përgatitjes së	Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria Komunale.	Do të fillojmë nga ky vit dhe

	munjon referimi i ndonjë standardi për pozicionet e punëve të kryera.	duke iu referuar (I) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian. (II) një standardi Evropian. (III) një miratimi teknik Evropian, (IV) një specifikimi të përbashkët teknik (V) një standardi ndëkombëtar apo (VI) qfardo referimi tjetër teknik të nxjerr nga organet evropiane për standardizim.	duhet të përcaktoj edhe një standard të cilësishë së materialeve që kërkohen për realizim e atij projekti.	specifikave teknike nga njësia kërkuese.		do jetë vazhdimësi.	
7	Çështja A3 – Publikimi me vonesë në sistemin e e-prokurimit.	Rregullore nr. 001/2022 për prokurim neni 45.36 përcakton, pas nënshkrimit të kontratës nga të dy palët, dhe publikimit të njoftimit për nënshkrim të kontratës (B52), kontrata do të jetë në dispozicionin për t'u shikuar nga publiku, dhe nga zyrtarët brenda autoritetit kontraktues të ndërlidhur me implementimin të kontratës.	Kryetari duhet të sigurojë se se me rasin e nënshkrimit të kontratave, të bëhet publikimi i tyre në e-prokurim, në mënyrë që t'i mundësohet qasje të gjitha palëve të interesit sipas rregullores përkatëse.	Ka filluar së zbatuari.	Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Administratës dhe Zyra e Prokurimit	Duke u zbatuar.	
8	Çështja B5 – Dobësitë në menaxhimin e Llogarive të arkëtueshme	Sipas nenet 26 të ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr.06-L005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) € dhe neni 27 nëse një tatim pagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin	Kryetari duhet të sigurojë se mbledhja e llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë bëhet sipas kërkesave dhe mënyrave të përcaktuara ligjor. Ndërsa për llogaritë arkëtueshme nga taksa në biznes dhe të qirave të biznes dhe të qirave të shqyrtohen të gjitha	Me rasin e inkasimit të borjeve nga vitet e kaluara për Tatimin në Pronë, ZKTP dhe Drejtoria e Financave në bashkëpunim edhe me DTP në Ministri do të rrisin aktivitetet duke	Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa.	Gjatë vitit në vijim.	

		dhe gjobën në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pages ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë ditë kalendarikepas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.	opcionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore dhe deri përmes mjeteve juridike me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borjeve.	shpërndarë letër kujesa dhe vërejtje për tatimpaguesit e mëdhenjë, duke lidhur edhe marrëveshje me këste me qëllim të uljes së borjeve dhe rritjes së inkasimit për Tatimin në pronë. Ndërsa lidhur me taksat komunale, borjet e tyre do të konsultoheni me rregullativën ligjore për të vepruar më tuje për subjektet të cilat janë me vite joaktive.			
--	--	---	---	--	--	--	--

Malishevë Qershor 2023

Kryetari i Komunës

